

LIGJ PËR HIGJIENËN PUBLIKE

TEKST I KONSOLIDUAR 1

DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1

Me këtë ligj rregullohen kushtet dhe mënyra e mirëmbajtjes së higjienës publike, të drejtat dhe obligimet e pjesëmarrësve në mirëmbajtjen e higjienës publike, sipërfaqet dhe objektet në të cilat bëhet mirëmbajtja e higjienës publike, grumbullimi i hedhurinës, pastrimi i borës në kushte dimërore.

Neni 2

Mirëmbajtja e higjienës publike, grumbullimi i hedhurinës dhe pastrimi i borës në kushte dimërore janë veprimtari me interes publik me rëndësi lokale.

Neni 3

Mirëmbajtja e higjienës publike është proces në kontinuitet që siguron pastrimin e përhershëm dhe kualitativ të sipërfaqeve publike, të objekteve publike, të lokaleve të hapura në objektet publike, në tokë ndërtimore pa ndërtim pronësi e personave fizikë dhe juridikë në rajonin qendror të komunës, komunave në qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit, dhe sipërfaqeve në oborret e objekteve kolektive dhe individuale për banim, për shkak të sigurimit të mjedisit të shëndoshë dhe të pastër.

Neni 4

Dispozitat e këtij ligji nuk kanë të bëjnë me mirëmbajtje e higjienës publike në rrethana të jashtëzakonshme dhe në kushtet e fatkeqësive elementare.

Neni 5

Disa shprehje të përdorura në këtë ligj e kanë kuptimin si vijon:

- "Mirëmbajtje e higjienës publike" është pastrimi (fshirja dhe larja) i sipërfaqeve publike dhe lokaleve të hapura, si dhe pastrimi i borës në kushtet e dimrit;
- "Grumbullimi i mbeturinës" është mënjanimi i mbeturinës nga mirëmbajtja e higjienës publike të sipërfaqeve dhe objekteve publike dhe vendosja në enë për mbeturina;
- "Mbeturinë" është grumbulli i hedhurinave që grumbullohen gjatë mirëmbajtjes së higjienës publike;
- "Sipërfaqe publike dhe lokale të hapura të objekteve publike" janë rrugët, trotualet, rrugicat për biçikleta, sheshet, brigjet e lumenjve, nënkallimet, mbikalimet, urat, parkingjet, shkallët që i lidhin sipërfaqet e trafikut publik, parqet e qytetit, malet-park, sipërfaqet rrugore me barë, fushëpamjet, vendkalimet kufitare, aeroporte, stacionet hekurudhore, stacionet e autobusëve, pompat e benzinës, dhe stacionet e taksive dhe objektet tjera të infrastrukturës komunale, kabinat telefonike, kopshtet zoologjike, varrezat e qytetit, panairët, tregjet, magazinat, depot, objektet rekreative sportive (fushat sportive, hipodromet, poligonet për qitje) banjat publike dhe sipërfaqet e hapura pranë objekteve tjera publike;
- "Rajoni qendror i komunës, komunave në qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit" është rajon i përcaktuar me akt të komunës dhe komunave në qytetin e Shkupit me të cilat kryhet ndarja në zona e rajonit të komunës dhe komunave në qytetin e Shkupit, si dhe në rajonin e qytetit të Shkupit të përcaktuar me akt të qytetit të Shkupit si rajon qendror;
- "Dhënës të shërbimit" janë ndërmarrjet publike ose personat juridikë të cilëve u është besuar kryerja e punëve të higjienës publike;

7. "Shfrytëzues të shërbimeve" janë shfrytëzuesit e sipërfaqeve publike dhe të lokaleve të hapura në objekte publike, dhe

8. "Sipërfaqe e oborrit" është sipërfaqja pranë objekteve kolektive dhe individuale për banim dhe rreth objekteve publike, të caktuara me planin urbanistik.

Neni 5-a

Në procedurë gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese do të zbatohen dispozitat e Ligjit për mbikëqyrje inspektuese, nëse me këtë ligj nuk rregullohet ndryshe.

II. KUSHTET DHE MËNYRA E MIRËMBAJTJES SË HIGJENËS PUBLIKE

Neni 6

Shfrytëzuesit respektivisht pronarët e lokaleve të hapura në objektet publike, në tokë ndërtimore pa ndërtim pronësi e personave fizikë dhe juridikë në rajonin qendror të komunës, komunave në qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit, dhe sipërfaqet e oborreve të objekteve kolektive dhe individuale për banim janë të detyruar që të njëjtat në mënyrë të rregullt t'i mirëmbajnë në mënyrë me të cilën nuk ndotet dhe nuk degradohet sipërfaqja në mjediset urbane dhe rregullisht ta mënjanojnë mbeturinën nga të njëjtat.

Neni 7

Mirëmbajtja e higjienës publike dhe pastrimi i borës dhe i akullit në kushtet e dimrit në sipërfaqet publike bëhet nëpërmjet ndërmarrjes publike për shërbime komunale, të themeluar nga komuna, komunat e Qytetit të Shkupit dhe Qyteti i Shkupit.

Punët e mirëmbajtjes së higjienës publike, komuna, komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit me vendim të Këshillit mund t'ia transmetojë për kryerje personit juridik të regjistruar për kryerjen e këtyre punëve, në pajtim me ligjin.

(3) Personi juridik nga paragrafi (2) i këtij neni, duhet të posedojë leje për mirëmbajtjen e pastërtisë publike, të lëshuar nga organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e punëve të komunaleve.

(4) Për marrjen e lejes nga paragrafi (3) i këtij neni, personi juridik parashtrohet në organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e punëve të komunaleve dhe dëshmi me të cilat do të dëshmojë se i plotëson kushtet si vijojnë:

- të ketë seli në Republikën e Maqedonisë,
- të jetë i regjistruar për kryerjen e punëve për mirëmbajtjen e pastërtisë publike,
- të mos jetë ngritur procedurë për falimentim ose procedurë për likuidim,
- personi përgjegjës ose anëtar i organit menaxhues të personit juridik të mos jetë i dënuar në mënyrë të plotfuqishme për veprë penale në financat publike, qarkullimin pagesor dhe ekonomi ose vepra penale kundër marrëdhënieve të punës, derisa zgjasin pasojat e aktgjykimit, ose të mos i jetë kumtuar sanksion kundërvajtës ndalim për ushtrimin e veprimtarisë derisa zgjat ndalimi,
- të dorëzojë dokument për aftësi ekonomike dhe financiare, të lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë,
- të jetë i siguruar në shoqëri të sigurimit dhe të paraqesë dëshmi me shkrim për aftësinë për kompensim të dëmit eventual të shkaktuar lidhur me përgjegjësinë në ushtrimin e veprimtarisë së tij në pajtim me ligj,
- të ketë të punësuar së paku pesë persona, të cilët i nënshtrohen vaksinimit të detyrueshëm në pajtim me rregullat për mbrojtje nga sëmundjet ngjitëse dhe
- të ketë pajisje teknike përkatëse (një automjet të specializuar për marrjen e plehrave, pajisje MHT për të punësuarit dhe mjete teknike të domosdoshme për mirëmbajtjen e pastërtisë publike).

(5) Provat për plotësimin e kushteve nga paragrafi (4) alinetë 1, 2, 3 dhe 5 të këtij neni i siguron personi zyrtar i autorizuar nga organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e punëve komunale që mban procedurë për lëshimin e lejes për mirëmbajtjen e pastërtisë publike, i cili është i obliguar në afat prej tre ditësh nga dita e pranimit të kërkesës t'i kërkojë provat nga organi publik kompetent.

(6) Personi i autorizuar zyrtar nga organi kompetent është i detyruar provat e kërkuara nga paragrafi (5) nga ky nen t'i dorëzojë në afat prej tre ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

(7) Për lejet e lëshuara për mirëmbajtjen e pastërtisë publike, organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e punëve të komunaleve, mban regjistër të lejeve të lëshuara për mirëmbajtjen e pastërtisë publike, i cili publikohet në ueb faqen e tij.

(8) Formën dhe përmbajtjen e kërkesës, formën dhe përmbajtjen e formularit të lejes, mënyrën e lëshimit dhe heqjes së lejes, formën dhe përmbajtjen e regjistrit nga paragrafi (5) i këtij neni, si dhe mënyrën e mbajtjes së tij, i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e punëve të komunaleve.

Neni 7-a

(1) Nëse konstatohet se personi juridik nga neni 7 paragrafi (3) i këtij ligji, i plotëson kushtet për marrjen e lejes, organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e punëve të komunaleve, do të lëshojë leje për mirëmbajtjen e pastërtisë publike në afat prej 15 ditësh nga pranimi i kërkesës me dokumentacionin e plotë, në të kundërtën, do të miratojë aktvendim me të cilin refuzohet kërkesa për lëshimin e lejes.

(2) Kundër aktvendimit nga paragrafi (1) të këtij neni mund të parashtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga pranimi i aktvendimit te Komisioni shtetëror për vendimmarrje në procedurë administrative dhe procedurë nga marrëdhënia e punës në shkallë të dytë.

(3) Leja për mirëmbajtjen e pastërtisë publike hiqet, nëse personi juridik pushon të plotësojë cilindo prej kushteve të përcaktuara në nenin 7 paragrafi (4) të këtij ligji.

Neni 7-b

I fshirë 2

Neni 8

Të drejtat dhe obligimet ndërmjet komunave, komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit dhe personit juridik nga neni 7 paragrafi 2 i këtij ligji rregullohen me marrëveshje e cila përmban:

- llojin dhe vëllimin e punëve,
- mënyrën dhe afatin e pagesës për kryerjen e punëve,
- garantimin për plotësimin e obligimeve të marrëveshjes etj.

Marrëveshja nga paragrafi 1 i këtij neni mund të lidhet më së gjati për një periudhë prej katër vjetësh.

Neni 9

Mirëmbajtjen e higjienës publike në lokalet e hapura të objekteve publike në pronë shtetërore, respektivisht në pronë komunale e kryen komuna, komunat e Qytetit të Shkupit dhe Qyteti i Shkupit, ndërsa atë të objekteve në pronë private dhe në sipërfaqet e oborreve të objekteve kolektive dhe individuale për banim, dhe në sipërfaqet e oborrit të objekteve publike e bën pronari i objektit.

Mirëmbajtjen e higjienës publike në lokalet e hapura të kalimeve kufitare dhe aeroporteve, e kryen pronari, qiramarrësi ose koncesioneri i objektit, në mënyrë të pavarur ose me kalimin e kryerjes së punëve personave juridikë të regjistruar për mirëmbajtjen e higjienës publike dhe të cilët posedojnë leje për mirëmbajtjen e pastërtisë publike, në pajtim me ligjin.

Në ndërtesat kolektive për banim mirëmbajtjen e higjienës publike obligohet ta bëjë bashkësia e pronarëve respektivisht drejtori.

(4) Mirëmbajtjen e pastërtisë publike në tokë ndërtimore pa ndërtime pronësi e personave fizikë dhe juridikë në rajonin qendror të komunës, komunave në qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit e kryen pronari i tokës.

Neni 10

Për rregullimin më të afërt të marrëdhënieve për mirëmbajtjen e higjienës publike, Këshilli i komunës dhe i komunave të Qytetit të Shkupit dhe Këshilli i Qytetit të Shkupit merr vendim.

Me vendimin nga paragrafi 1 i këtij neni rregullohet: mirëmbajtja e higjienës publike të sipërfaqeve publike, mënyra e shfrytëzimit të sipërfaqeve publike dhe grumbullimi i mbeturinave, pastrimi i borës dhe akullit, mënjanimi i sendeve që e rrezikojnë higjienën publike, si dhe masat për zbatimin e vendimit.

Neni 11

Kontrollin e mirëmbajtjes së higjienës publike në pajtim me vendimin nga neni 10 paragrafi 1 i këtij ligji e bëjnë kujdestarët komunalë.

Kujdestarët komunalë nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të kenë së paku shkollim të mesëm.

Kujdestarët komunalë gjatë kryerjes së kontrollit detyrimisht mbajnë veshje zyrtare dhe legjitimacion zyrtar.

Legjitimacionin zyrtar nga paragrafi (3) i këtij neni e lëshon kryetari i komunës, kryetarët e komunave të Qytetit të Shkupit dhe kryetari i Qytetit të Shkupit.

Ngjyrën dhe modelin e veshjes zyrtare, formën dhe përmbajtjen dhe mënyrën e lëshimit dhe të tërheqjes së legjitimacionit zyrtar të kujdestarëve komunalë i përcakton ministri i Transportit dhe Lidhjeve.

Neni 11-a

(1) Në procedurën gjatë kryerjes së kontrollit nga neni 11 paragrafi (1) i këtij ligji, kujdestarët e komunaleve kur do të hasin aty për aty person gjatë kryerjes së kundërvajtjeve të përcaktuara me nenin 33 dhe 33-a të këtij ligji, kanë autorizim që ta ndalin personin dhe të kryejnë përcaktim të identitetit të tij.

(2) Gjatë ndërmarrjes së veprimeve nga paragrafi (1) i këtij neni, kujdestari i komunaleve e ka për detyrë që të legjitimohet dhe ta njoftojë personin për kundërvajtjen që e ka kryer aty për aty.

(3) Kontrollin e identitetit të personit, kujdestari i komunaleve e kryen me shikim të dokumentit të tij publik (letërnjoftim ose pasaportë) ose dokument tjetër me fotografinë e tij, nga i cili mund të përcaktohet identiteti i personit (patentë shoferi, legjitimacion shëndetësor, legjitimacion të studentit), e pastaj menjëherë ia kthen dokumentin personit.

(4) Nëse personi refuzon të japë të dhëna për vete ose nuk do ta dëshmojë identitetin me dokumentet nga paragrafi (3) i këtij neni, kujdestari i komunaleve e njofton stacionin më të afërt policor për nevojën e pranisë së nëpunësit policor në vendin e kryerjes së kundërvajtjes.

Neni 12

Për kryerjen e punëve të mirëmbajtjes së higjienës publike komunat, komunat e Qytetit të Shkupit dhe Qyteti i Shkupit çdo vit miratojnë program vjetor i cili përmban: llojin dhe vëllimin e punëve që duhet të bëhen, mjetet financiare, afatet kohore për kryerjen e punëve, dinamikën dhe mënyrën e kryerjes së punëve.

Programi nga paragrafi 1 të këtij neni përmban edhe sigurimin e nyjeve sanitare publike dhe vendosjen e enëve përkatëse për qitjen e hedhurinave në sipërfaqet publike dhe në lokalet e hapura para objekteve publike.

Mënyra e vendosjes së enëve përkatëse për qitjen e hedhurinave rregullohet në vendimin nga neni 10 të këtij ligji.

Personat zyrtarë në organet e komunës, të komunave në Qytetin e Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit, janë të obliguar që si persona përgjegjës me kohë dhe në mënyrë efikase të ndërmarrin masa për zbatimin e dispozitave nga paragrafi 2 dhe 3 të këtij neni.

III. OBLIGIMET E PJESËMARRËSVE NË MIRËMBAJTJEN E HIGJENËS PUBLIKE

Neni 13

Çdo person fizik dhe juridik është i detyruar që të kujdeset për mirëmbajtjen e higjienës publike.

Neni 14

Për shkak të sigurimit të higjienës publike në sipërfaqet publike ndalohet:
- hedhja dhe lënia e letrës, bishtave të cigares, çamçakëzëve, ambalazheve, dheut, hedhurinave të bimëve, rërës dhe hedhurinave tjera përveç në vendet e përcaktuara për atë dedikim,
- lënia e sendeve të vjetra të amvisërisë dhe mbeturinave nga kryerja e veprimtarive pranë enëve për

grumbullimin e mbeturinës, përveç në vende të përcaktuara nga komuna,

- lënia e fekaleve të kafshëve shtëpiake dhe kafshëve të ngordhura, shpezëve dhe zogjve në enë për hedhurina, përveç për vendet e caktuara për atë qëllim
- therja e pulave, shpendëve dhe kafshëve të tjera,
- lëshimi i ujërave të zeza dhe lëngjeve tjera nga sipërfaqet e oborreve dhe objekteve,
- derdhja dhe lëshimi i lëngjeve në enë për hedhurina, në rrugë, në kanale, në lumenj dhe në liqene,
- prerja, vendosja, çarja e druve, thëngjillit etj., përveç për vendet e caktuara për atë qëllim,
- lënia e karrocave, traktorëve, makinave bujqësore dhe pajisjeve,
- ruajtja dhe kullotja e kafshëve dhe shpendëve,
- shitja dhe prezantimi i produkteve bujqësore dhe industriale, përveç për vendet e caktuara për atë qëllim,
- vendosja e pajisjes urbane dhe e sendeve të tjera të lëvizshme dhe të palëvizshme.
- përzjerja e betonit, llaçit, përveç në vendet që do t'i caktojë komuna,
- derdhja e mbeturinës nga thasët, enët për hedhurina dhe enët tjera për grumbullimin e mbeturinës,
- hedhja, respektivisht lënia e mbeturinës pranë enëve dhe llojeve tjera të enëve,
- hedhja e mbeturinës nga cili do kat i ndërtesës ose shtëpisë, në oborr,
- vendosja e kovave dhe llojeve tjera të enëve për grumbullimin e mbeturinës jashtë vendeve të caktuara për vendosjen e tyre, në pajtim me dedikimin e tyre,
- të pështrirët ose pastrimi i hundëve në sipërfaqe publike,
- ngjitja e afisheve në cilindo vend publik, përveç për vendet e caktuara për atë qëllim dhe
- kryerja e nevojave fiziologjike.

Neni 14-a

Për sigurim të pastërtisë publike në sipërfaqet publike ndalohet:

- hedhja dhe lënia e hedhurinave nga materiali ndërtimor (hedhurinë ndërtimore),
- djegia, groposja dhe asgjësimi i plehut,
- transporti i rërës, tokës, cementit, argjilës, plehut bujqësor, hedhurinës apo materialeve të ngjashme pa përgatitje paraprake dhe mbulim të materialeve me kapak,
- përfshirja në komunikacion e automjeteve motorike, tërheqëse dhe rimorkuese nga vendshkarkimet apo kantieret me rrota të ndyra,
- ndreqja, servisimi i automjeteve dhe kryerja e punëve të ndryshme zejtare,
- djegia dhe asgjësimi i enëve për grumbullim të plehut dhe
- asgjësimi i pajisjes urbane dhe pajisjes tjetër (stolave, shatërvanëve, billbordeve, pajisjes së këndeve të lojërave për fëmijë).

(2) Për shkak të sigurimit të pastërtisë publike të tokës ndërtimore pa ndërtime pronësi e personave fizikë dhe juridikë në rajonin qendror të komunës, komunave në qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit ndalohet:

- hedhja dhe lënia e hedhurinave të materialit ndërtimor (hedhurina ndërtimore), lënia e letrave, bishtave të cigares, çamçakëzëve, ambalazheve, dheut, hedhurinave nga bimët, rërës dhe hedhurinave tjera,
- lënia e sendeve të vjetra të amvisërisë dhe hedhurina nga kryerja e veprimtarive,
- ndezja, groposja dhe asgjësimi i hedhurinave,
- lënia e mbeturinave fekale të kanakarëve shtëpiake dhe kafshëve, shpezëve dhe zogjve të ngordhur,
- therja e pulave dhe shpezëve dhe kafshëve tjera,
- prerja, magazinimi, çarja e druve, qymyrit dhe të ngjashme,
- lënia e automjeteve tërheqëse, traktorëve, makinave bujqësore dhe veglave, automjeteve të dëmtuara, të paregjistruara, rimorkiove kamp-rimorkiove,
- ruajtja dhe kullotja e kafshëve të mëdha dhe shpezëve,
- shitja dhe ekspozimi i prodhimeve bujqësore dhe industriale,
- riparimi, servisimi i automjeteve dhe kryerja e punëve të ndryshme zejtare,
- shpërndarja e hedhurinave nga thasët, kontejnerët dhe nga llojet tjera të enëve për grumbullimin e hedhurinave,
- hedhja e mbeturinave nga cili do kat i ndërtesës së banimit ose shtëpisë,
- pështrirja ose fryrja e hundëve dhe
- kryerja e nevojave fiziologjike.

Neni 15

Pronari, respektivisht personi i cili administron me objekt publik, është i detyruar që ta mirëmbajë higjienën publike në objektin publik dhe sipërfaqen e oborrit të tij, me ç'rast duhet të sigurojë:

- pastrimin e rregullt dhe mirëmbajtjen e lokaleve në objekt;
- enë për hedhjen e mbeturinave dhe
- instalimet në një sanitare të jenë në gjendje të rregullt dhe të pastra dhe të sigurojë letër tualeti, makina për terjen e duarve ose letër në çdo kohë.

Neni 16

Brenda respektivisht në korridoret e objekteve publike ndalohet hedhja e mbeturinave, pështyma, hedhja e bishtave të cigareve, çamçakëzëve dhe sendeve tjera ose futja e kafshëve shtëpiake përveç me leje nga administruesi i objektit publik.

Neni 17

Në objektet publike dhe në objektet kolektive dhe individuale, strehimore dhe afariste ndalohet shënimi i grafiteve, vendosja e reklamave ndriçuese dhe video bilbordeve si dhe ngjitja e afisheve.

Me përjashtim të paragrafit 1 të këtij neni, në vende dhe objekte të caktuara për këtë qëllim nga ana e komunave, komunave në Qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit, mund të vendosen reklama ndriçuese, video bilborde dhe të ngjiten afishe.

Neni 18

Personat juridikë dhe fizikë pronarë të objekteve, pronarët e tokës ndërtimore pa ndërtime në rajonin qendror të komunës, komunave në qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit. Respektivisht pronarët dhe shfrytëzuesit e lokaleve të hapura në objekte publike që janë për përdorimin e rregullt të këtyre objekteve publike janë të detyruar që ato lokale rregullisht t'i mirëmbajnë në atë mënyrë që nuk do të krijojnë mbeturina dhe hedhurina tjera si dhe ta mirëmbajnë gjelbërimin e atyre lokaleve. 3

Neni 19

Për shkak të sigurimit të higjienës publike në lokale të hapura të objekteve publike ndalohet:

- hedhja dhe lënia e lëndëve nga amvisëritë, gjetheve, degëve, rrënjëve të bimëve, rërës, hedhurinave të materialit ndërtimor, llojeve të ndryshme të ambalazhit
- lënia e mbeturinës nga kryerja e veprimtarive të personave juridikë dhe fizikë pranë enëve për grumbullimin e mbeturinave,
- ndezja, futja në dhe, dhe asgjësimi i mbeturinës,
- lënia e kafshëve të ngordhura, shpendëve dhe zogjve,
- lëshimi i ujërave të zeza dhe lëngjeve tjera nga sipërfaqet e oborreve dhe objekteve,
- larja e veturave dhe kamp rimorkiove, sendeve tjera të amvisërisë dhe sendeve të personave juridik,
- prerja, vendosja e drunjve, thëngjillit etj.
- prodhimi, pjekja e gëlqeres dhe thëngjillit, si dhe vendosja dhe ruajtja e materialit ndërtimor pa leje të dhënë nga organi kompetent,
- riparimi, servisimi i automjeteve dhe kryerja e punëve të ndryshme të zejeve,
- lënia e sekretit të kafshëve shtëpiake dhe kafshëve shtëpiake.

Neni 20

Organizatorët e manifestimeve publike (kulturore, sportive, dhe manifestimeve tjera) të mitingjeve, kremtimeve, dhe tubimeve tjera janë të detyruar që menjëherë pas mbarimit të manifestimit respektivisht tubimit ta mbledhin mbeturinën e bërë nga pjesëmarrësit e manifestimit respektivisht tubimit dhe ta lënë në vendin e caktuar për atë dedikim.

Gjatë vizitës në vende pikniku vizitorët janë të detyruar që para kthimit nga vendi i piknikut ta grumbullojnë mbeturinën dhe ta lënë në vendin e caktuar të paraparë për atë dedikim.

Neni 21

Shfrytëzuesit e instilacioneve në nyjat sanitare publike dhe në nyjet sanitare në objektet publike, me qëllim të sigurimit të higjienës publike janë të detyruar që pas shfrytëzimit të të njëjtave detyrimisht ta shkarkojnë ujin.

Neni 22

Në kushte dimri gjatë reshjeve të dëborës komunat, komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit janë të detyruar ta pastrojnë dëborën nga sipërfaqet publike më së voni në afat prej 6 orësh nga fillimi i reshjeve të dëborës.

Në kushte dimri gjatë reshjeve të dëborës të gjithë pronarët, përkatësisht shfrytëzues të objekteve publike janë të detyruar që menjëherë të fillojnë me pastrimin e dëborës në hapësirat e hapura para objekteve publike, me çka do të siguroj qasje të pandërprerë në objektet.

Neni 23

Të gjithë pronarët, përkatësisht shfrytëzues të objekteve janë të detyruar në mënyrë të rregullt ta grumbullojnë dhe vendosin në vende të caktuara për atë destinim.

Personat juridik që i bëjnë punët e mirëmbajtjes së higjienës publike janë të detyruar që mbeturinat nga sipërfaqet publike në mënyrë të rregullt t'i grumbullojnë dhe vendosin në vende të caktuara për atë destinim.

IV. MJETET PËR MIRËMBAJTJEN E HIGJENËS PUBLIKE

Neni 24

Për mirëmbajtjen e higjienës publike paguhet kompensim.

Lartësinë e kompensimit nga paragrafi 1 i këtij neni e përcakton Këshilli i komunës, këshillat e komunave në Qytetin e Shkupit dhe Këshilli i Qytetit të Shkupit varësisht prej ndërtimit, rregullimit të sipërfaqeve publike dhe nevojës - vëllimit për mirëmbajtjen e sipërfaqeve publike në rajonin e tyre.

Këshilli i komunës, këshillat e komunave në Qytetin e Shkupit dhe këshilli i Qytetit të Shkupit e përcakton njësinë matëse sipas së cilës do të paguhet kompensimi nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 25

Arkëtimi i kompensimit për mirëmbajtjen e higjienës publike bëhet përmes dërgimit të faturave për grumbullimin dhe transportimin e hedhurinave komunale dhe të llojeve të tjera të hedhurinave të parrezikshme, i cili shprehet ndaras në faturë.

Me përjashtim të paragrafit 1 arkëtimi i kompensimit për mirëmbajtjen e higjienës publike mund të bëhet edhe ndaras përmes dërgimit të faturës së veçantë shfrytëzuesit të shërbimit, kur mirëmbajtjen e higjienës publike e bën personi juridik i ndryshëm nga personi i cili bën grumbullimin dhe transportimin e hedhurinave komunale dhe llojeve të tjera hedhurinash të parrezikshme.

Mjetet e grumbulluara nga kompensimi për mirëmbajtjen e higjienës publike janë të hyra të komunës, të komunave në Qytetin e Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit dhe shfrytëzohen për financimin e punëve të higjienës publike.

V. MBIKËQYRJA

Neni 26

Mbikëqyrjen mbi zbatimin e këtij ligji dhe dispozitat e miratuara në bazë të këtij ligji e bën organi i administratës publike kompetent për kryerjen punëve nga sfera e punëve komunale.

Mbikëqyrjen inspektuese e bëjnë inspektorët komunal të komunës, inspektorët komunalë të komunave në Qytetin e Shkupit.

Inspektorati shtetëror komunal kryen mbikëqyrje inspektuese për mirëmbajtjen e higjienës publike në lokalet e hapura të kalimeve kufitare dhe aeroporteve dhe në raste kur komunat, komunat në Qytetin e Shkupit përkatësisht Qyteti i Shkupit nuk kanë inspektor të autorizuar komunal. Në raste kur mbikëqyrjen inspektuese e bën Inspektorati shtetëror komunal, meqë nuk ka të autorizuar inspektor komunal, mbikëqyrja inspektuese kryhet në llogari të komunës, komunave në Qytetin e Shkupit, përkatësisht Qytetit të Shkupit.

Inspektorati shtetëror komunal krahas punëve të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni, gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese kontrollon, nëse:

- në ndërmarrjen publike për mirëmbajtje të pastërtisë publike apo në personin juridik ku kryhet puna me dobi të përgjithshme, drejtori ka autorizuar person për kryerje të kontrollit gjatë kryerjes së punës me dobi të përgjithshme,

- puna me dobi të përgjithshme kryhet në mënyrën në pajtim me këtë ligj,

- në ndërmarrjen publike për mirëmbajtje të pastërtisë publike apo në personin juridik ku kryhet punë me dobi të përgjithshme, drejtori ka autorizuar person për fotografim të personave të cilët kryejnë punë me dobi të përgjithshme dhe

- fotografimi kryhet në mënyrën në pajtim me këtë ligj.

Inspektorët komunalë të Qytetit të Shkupit mbikëqyrjen inspektuese e kryejnë në sipërfaqet publike, në tokë ndërtimore pa ndërtime pronësi e personave fizikë dhe juridikë në rajonin qendror të qytetit, dhe në lokalet e hapura të objekteve publike që janë me interes publik me rëndësi lokale për Qytetin e Shkupit në pajtim me ligjin.

Inspektorët komunalë të komunave në Qytetin e Shkupit mbikëqyrjen inspektuese e kryejnë në sipërfaqet publike, në tokë ndërtimore pa ndërtime pronësi e personave fizikë dhe juridikë në rajonin qendror të komunës, komunave në qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit, dhe në lokalet e hapura të objekteve publike të cilat janë me interes publik me rëndësi lokale të komunës përkatëse në Qytetin e Shkupit në pajtim me ligjin.

Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese inspektori komunal i Komunës, inspektori komunal i komunave në Qytetin e Shkupit kontrollon nëse:

- rregullisht mirëmbahet higjiena publike në sipërfaqet publike nga ana e Ndërmarrjes publike ose personit juridik të cilit i janë besuar punët për mirëmbajtjen higjienës publike,
- mirëmbahet higjiena publike në hapësirat e hapura të objekteve publike dhe në sipërfaqet e oborreve të objekteve kolektive dhe individuale për banim,
- pastrohet
- janë siguruar enë për hedhjen e hedhurinave në brendësi, përkatësisht në korridoret e objekteve publike, në tokë ndërtimore pa ndërtime në rajonin qendror të komunës, komunave në qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit, dhe të nyjeve sanitare,
- gjatë mbajtjes së manifestimeve publike, janë pastruar mbeturinat,
- në vende pikniku janë pastruar mbeturinat.

Neni 26-a

I fshirë 4

Neni 27

Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese inspektori komunal i komunës, inspektori komunal i komunave në Qytetin e Shkupit dhe inspektori shtetëror i komunaleve për parregullsitë e konstatuara përpilon procesverbal dhe merr vendim me caktimin e afatit për mënjanimin e parregullsive.

Kundër aktvendimit të inspektorit komunal të komunës, inspektorit komunal të komunave në Qytetin e Shkupit, përkatësisht inspektorit komunal të Qytetit të Shkupit mund të parashtrohet ankesë në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit në Komisioni shtetëror për vendimmarrje në shkallë të dytë në sferën e mbikëqyrjes inspektuese dhe procedurës për kundërvajtje (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni Shtetëror).

Kundër aktvendimit të inspektorit shtetëror komunal, mund të parashtrohet ankesë në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit në Komisionin Shtetëror.

Ankesa nuk e shtyn zbatimin e vendimit.

Neni 27-a

I fshirë 5

Neni 28

Nëse në afatin e përcaktuar në nenin 27 paragrafin 1 të këtij ligji personi nuk vepron sipas vendimit të inspektorit komunal të komunës, inspektori komunal i komunave në Qytetin e Shkupit dhe Inspektorit shtetëror të komunaleve mënjanimin e mbeturinave, përkatësisht pastrimin e dëborës do ta bëjë ofruesi i shërbimit në llogari të personit të theksuar në vendim.

(2) Nëse pronari i tokës ndërtimore pa ndërtime në rajonin qendror të komunës, komunave në qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit nuk vepron sipas vendimit të inspektorit të komunës për shërbime komunale, inspektorit komunal në komunat e qytetit të Shkupit respektivisht inspektorit komunal në qytetin e Shkupit, mënjanimin e hedhurinave do ta kryejë dhënësi i shërbimit në llogari të tij.

Neni 28-a

Mbikëqyrjen lidhur me ligjshmërinë e punës së organeve të komunës, të organeve të komunave në Qytetin e Shkupit dhe të organeve të Qytetit të Shkupit i kryen organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga lëmi i punëve komunale, për punët nga kompetenca e tyre të cilat kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e higjienës publike.

Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes nga paragrafi 1 të këtij neni, organi i administratës shtetërore për kryerjen e punëve nga lëmi i punëve komunale i kryen punët në vijim:

- 1) e ndjek ligjshmërinë e punës së organeve të komunës, komunave në Qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit dhe ndërmerr masa, aktivitete dhe parashtron iniciativa për realizimin e kompetencave të tyre;
- 2) iu bën vërejtje organeve të komunave, komunave në Qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit në tejkalimin e kompetencave të tyre të përcaktuara me këtë ligj dhe propozon masa përkatëse për tejkalimin e kësaj gjendje;
- 3) bën vërejtje për materiale edhe mangësi të caktuara procedurale në punën e organeve të komunave, të komunave në Qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit të cilat do të mund ta pamundësonin kryerjen e punëve të përcaktuara me këtë ligj;
- 4) jep rekomandime për zbatimin konsequent të kompetencave për punët të cilat duhen t'i kryejnë komunat, komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit, në pajtim me këtë ligj, e me kërkesë të tyre;
- 5.) e ndjek miratimin me kohë të akteve nga komuna, komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit;
- 6) jep mendim dhe ndihmë profesionale me kërkesën e organeve të komunës, komunave në Qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit me propozim të akteve të cilat dalin nga ky ligj;
- 7) e ndjek realizimin e transparencës në punën e organeve të komunës, komunave në Qytetin e Shkupit dhe Qytetit të Shkupit nga aspekti i informimit të rregullt, më kohë, të vërtetë dhe të plotë të qytetarëve për punët e përcaktuara me këtë ligj, dhe
- 8) i informon me kohë organet e komunës, komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qytetin e Shkupit për gjendjet e konstatuara në punën e tyre dhe për masat e ndërmarra gjatë kryerjes së mbikëqyrjes.

Për masat dhe aktivitetet e ndërmarra nga paragrafi 2 të këtij neni organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga lëmi i punëve komunale i informon organet e komunës, komunat në Qytetin e Shkupit, dhe Qytetin e Shkupit

VI. DISPOZITA PËR KUNDËRVAJTJE

Neni 29

Gjobë në shumë prej 4.000 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik, nëse:

- 1) nuk siguron mirëmbajtje të rregullt dhe kualitative të pastërtisë publike dhe pastrim të borës në sipërfaqe publike në kushte dimërore (neni 7),
- 2) kryen mirëmbajtje të pastërtisë publike pa posedim të lejes (nenet 7 dhe 9 paragrafi (2)) dhe
- 3) vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 14 alinetë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14 dhe 16 dhe nenit 14-a të këtij ligji.

Gjobë në lartësi prej 30% të gjobës së matur për personin juridik, do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni edhe personit përgjegjës në personin juridik.

Neni 29-a

Gjobë në shumë prej 3.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje drejtorit të ndërmarrjes publike për mirëmbajtje të pastërtisë publike apo drejtorit të personit juridik ku kryhet puna me dobi të përgjithshme, nëse lëshon vërtetim pa u kryer puna me dobi të përgjithshme (neni 40 paragrafi 5).

Gjobë në shumë prej 2.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit të autorizuar për kontroll gjatë kryerjes së punës me dobi të përgjithshme nëse nuk kryen kontroll apo nuk harton raport me shkrim për punën e kryer me dobi të përgjithshme, si dhe nëse harton raport me shkrim, kurse puna me dobi të përgjithshme nuk është kryer (neni 40 paragrafi 5).

Gjobë në shumë prej 3.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje drejtorit të ndërmarrjes publike për mirëmbajtje të pastërtisë publike apo drejtorit të personit juridik ku kryhet puna me dobi të përgjithshme, nëse nuk autorizon person për fotografim gjatë kryerjes së punës me dobi të përgjithshme (neni 40 paragrafi 6).

Gjobë në shumë prej 2.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit të autorizuar për fotografim gjatë kryerjes së punës me dobi të përgjithshme, nëse nuk kryen fotografim dhe nuk i ruan fotografitë nga puna e kryer me dobi të përgjithshme (neni 40 paragrafi 6).

Neni 30

Gjobë në shumë prej 500 euro me kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit zyrtar nëse vepron në kundërshtim me nenin 12 të këtij ligji.

Neni 31

I fshirë 6

Neni 32

Gjobë në shumë prej 3.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje personit juridik i cili është pronar ose menaxhon me objekt publik, nëse nuk vendos enë për hedhjen e hedhurinave dhe nuk siguron instalacione funksionale në nyje sanitare të objektit, nuk posedon letër tualeti, aparate për tharjen e duarve ose letër në çdo kohë (neni 15).

Gjobë në lartësi prej 30% të gjobës së matur për personin juridik, do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni edhe personit përgjegjës në personin juridik.

Neni 33

Gjobë në shumë prej 50 euro në kundërvlerë me denarë, në procedurën mandatore me lëshimin e mandatpagesës do t'i kumtohet personit fizik, nëse:

- vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 14 të këtij ligji,
- hedh mbeturina, bishta cigaresh, çamçakëzë dhe gjëra të tjera, përshtyn ose fut kafshë shtëpie pa leje të organit kompetent në brendësinë, përkatësisht në korridorët e objekteve publike (neni 16), dhe
- në objektet publike shkruan grafitë, vizaton ose ngjet pllakate (neni 17)

- vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 19 të këtij ligji dhe

- vepron në kundërshtim me dispozitat e neneve 20 paragrafi 2 dhe 21 të këtij ligji.

Neni 33-a

Gjobë në shumë prej 150 deri në 200 euro në kundërvlerë me denarë në procedurën për lëshimin e urdhërpagesës së kundërvajtjes do t'i shqiptohet personit fizik për kundërvajtje, nëse vepron në kundërshtim me dispozitat nga neni 14-a të këtij ligji.

Neni 34

Gjobë në shumë prej 2.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje personit juridik nëse vepron në kundërshtim me nenet 18 dhe 19 të këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 2.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje tregtarit individ nëse vepron në kundërshtim me nenet 18 dhe 19 të këtij ligji.

Gjobë në lartësi prej 30% të gjobës së matur për personin juridik, do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni edhe personit përgjegjës në personin juridik, përkatësisht personit përgjegjës në tregtarin individ.

Neni 35

Gjobë në shumë prej 3.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje personit juridik nëse vepron në kundërshtim me nenin 20 të këtij ligji.

Gjobë në shumë prej 3.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje tregtarit individ nëse vepron në kundërshtim me nenin 20 të këtij ligji.

Neni 36

I fshirë 7

Neni 37

Gjobë në vlerë prej 1.000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet personit juridik pronar, përkatësisht shfrytëzues i objektit publik nëse nuk e pastron borën nga lokali i hapur para objektit publik (neni 22 paragrafi 2).

Gjobë në lartësi prej 30% të gjobës së matur për personin juridik, do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni edhe personit përgjegjës në personin juridik.

Neni 37-a

(1) Gjobë në shumë prej 25 deri 50 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje të personit të autorizuar zyrtar nga organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e punëve komunale nëse nuk i kërkon provat sipas detyrës zyrtare në afatin e përcaktuar në nenin 7 paragrafi (5) të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 25 deri 50 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit të autorizuar zyrtar nga organi publik kompetent nga i cili nuk i dorëzon provat në afatin e përcaktuar në nenin 7 paragrafi (6) të këtij ligji.

(3) Gjobë në shumë prej 25 deri 50 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit të autorizuar zyrtar nga organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e punëve komunale nëse nuk vendos për kërkesën në afatin e përcaktuar në nenin 7-a paragrafi (1) të këtij ligji.

(4) Për kundërvajtjet nga paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni procedurë kundërvajtëse edhe sanksion kundërvajtës shqipton gjykata kompetente.

Neni 38

Kur inspektori komunal i komunaleve, inspektori i komunaleve i komunave në qytetin e Shkupit, inspektori i komunaleve në qytetin e Shkupit dhe nëpunësi policor me uniformë, do të konstatojnë se është kryer kundërvajtje nga nenet 29, 32, 34 dhe 35 të këtij ligji, do të parashtrijë kërkesë për ngritje të procedurës për kundërvajtje në gjykatën kompetente, ndërsa kur do të konstatojnë se është kryer kundërvajtje nga nenet 30, 33-a dhe 37 të këtij ligji, do të parashtrijë kërkesë për ngritje të procedurës për kundërvajtje para Komisionit për Vendimmarrje për Kundërvajtje në Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve.

Për kundërvajtjet nga paragrafi 1 i këtij neni, para parashtrimit të kërkesës për ngritje të procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente, përkatësisht para Komisionit për Vendimmarrje për Kundërvajtje në Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve, inspektori komunal i komunaleve, inspektori i komunaleve i komunave në qytetin e Shkupit, inspektori i komunaleve në qytetin e Shkupit dhe nëpunësi policor me uniformë, do të zbatojnë procedurë për barazim lëshohet urdhërpagesë e kundërvajtjes.

Kur inspektori komunal i komunaleve, inspektori i komunaleve të komunave në qytetin e Shkupit, inspektori i komunaleve në qytetin e Shkupit dhe nëpunësi policor me uniformë, do të konstatojnë kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni, përpilojnë procesverbal në të cilin shënohen elementet e rëndësishme të kundërvajtjes, koha, vendi dhe mënyra e kryerjes së kundërvajtjes, përshkrimi i veprimit të kundërvajtjes dhe personat e gjendur në vendin e ngjarjes. Procesverbalin e nënshkruan personi i autorizuar zyrtar dhe kryerësi. Nëse kryerësi e pranon kundërvajtjen, personi zyrtar do t'i japë urdhërpagesë të kundërvajtjes. për arkëtimin e gjobës për kundërvajtjen. **8**

Me nënshkrimin e urdhërpagesa e kundërvajtjes., konsiderohet se kryerësi i kundërvajtjes pajtohet që ta paguajë gjobën e shqiptuar. **9**

Kryerësi i kundërvajtjes nga paragrafi 1 i këtij neni është i obliguar që ta paguajë gjobën në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të urdhërpagesës së kundërvajtjes. në llogari të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, të shënuar në urdhërpagesën kundërvajtjes.. Kryerësi i cili do ta paguajë gjobën në afatin e përcaktuar në këtë paragraf do të paguajë vetëm gjysmën e gjobës së shqiptuar. **10**

Nëse kryerësi i kundërvajtjes refuzon të nënshkruhet në urdhërpagesa e kundërvajtjes., inspektori komunal i komunaleve, inspektori i komunaleve i komunave në qytetin e Shkupit, inspektori i komunaleve në qytetin e Shkupit dhe nëpunësi policor me uniformë, do të evidentojnë se personi ka refuzuar të nënshkruhet dhe të njëjtët do të nënshkruhen me emër dhe mbiemër të plotë në urdhërpagesë. **11**

Nëse kryerësi i kundërvajtjes nga paragrafi 1 i këtij neni, nuk e paguan gjobën në afatin e përcaktuar në urdhërpagesë të kundërvajtjes., inspektorët, përkatësisht nëpunësi policor me uniformë do të parashtrijë kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente, përkatësisht para Komisionit për Vendimmarrje për Kundërvajtje në Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve. **12**

Inspektori komunal i komunaleve, inspektori i komunaleve i komunave në qytetin e Shkupit, inspektori i komunaleve në qytetin e Shkupit dhe nëpunësi policor me uniformë, janë të obliguar që të mbajnë evidencë urdhërpagesat e kundërvajtjes të lëshuara dhe për rezultatin e procedurave të ngritura.. 13

Në evidencën nga paragrafi 8 i këtij neni mblidhen, përpunohen dhe ruhen të dhënat në vijim: emri dhe mbiemri, përkatësisht emri i kryerësit të kundërvajtjes, vendbanimi, përkatësisht vendqëndrimi, selia, lloji i kundërvajtjes, numri i urdhërpagesës së kundërvajtjes që i lëshohet dhe rezultati i procedurës.

Të dhënat personale nga paragrafi 9 i këtij neni ruhen pesë vjet nga dita e futjes në evidencë.

Formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës së kundërvajtjes i përcakton ministri i Transportit dhe Lidhjeve.

Neni 38-a

Kur inspektori shtetëror komunal do të përcaktojë se është kryer kundërvajtje nga neni 29-a të këtij ligji do të parashtrojë kërkesë për ngritje të procedurës për kundërvajtje te gjykata kompetente.

Për kundërvajtjet nga paragrafi 1 të këtij neni, para parashtrimit të kërkesës për ngritje të procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente, inspektori shtetëror komunal do të zbatojë procedurë të barazimit lëshimi i urdhërpagesës së kundërvajtjes.

Kur inspektori shtetëror komunal do të konstatojë kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni, harton procesverbal në të cilin shënohen elementet e rëndësishme të kundërvajtjes, koha, vendi dhe mënyra e kryerjes së kundërvajtjes, përshkrimi i veprimit të kundërvajtjes dhe personat e hasur në vendin e ngjarjes. Procesverbalin e nënshkruan personi i autorizuar zyrtar dhe kryerësi. Nëse kryerësi e pranon kundërvajtjen personi zyrtar do t'i lëshojë urdhërpagesa të kundërvajtjes për arkëtim të gjobës për kundërvajtje.

Me nënshkrimin e urdhërpagesa së kundërvajtjes konsiderohet se kryerësi i kundërvajtjes pajtohet që ta paguajë gjobën e shqiptuar.

Kryerësi i kundërvajtjes nga paragrafi 1 të këtij neni detyrohet ta paguajë gjobën në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të urdhërpagesa së kundërvajtjes në llogari të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë të shënuar në urdhërpagesa të kundërvajtjes. Kryerësi i cili do ta paguajë gjobën në afat të përcaktuar në këtë paragraf do ta paguajë vetëm gjysmën e gjobës së shqiptuar.

Nëse kryerësi i kundërvajtjes refuzon të nënshkruhet në urdhërpagesë të kundërvajtjes, inspektori shtetëror komunal do të evidentojë se personi ka refuzuar të nënshkruhet dhe ai do të nënshkruhet me emër dhe mbiemër të plotë në urdhërpagesë të kundërvajtjes.

Nëse kryerësi i kundërvajtjes nga paragrafi 1 i këtij neni nuk e paguan gjobën në afatin e përcaktuar në urdhërpagesë të kundërvajtjes, inspektori shtetëror komunal do të parashtrojë kërkesë për ngritje të procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente.

Inspektorët shtetërorë komunalë detyrohen të mbajnë evidencë për urdhërpagesat e kundërvajtjes të lëshuara dhe për rezultatin e procedurave të ngritura.. 14

Në evidencën nga paragrafi 8 i këtij neni mblidhen, përpunohen dhe ruhen të dhënat në vijim: emri dhe mbiemri, përkatësisht emri i kryerësit të kundërvajtjes, vendbanimi, përkatësisht vendqëndrimi, selia, lloji i kundërvajtjes, numri i urdhërpagesës së kundërvajtjes që i lëshohet dhe rezultati i procedurës.

Të dhënat personale nga paragrafi 9 i këtij neni ruhen pesë vjet nga dita e futjes në evidencë.

Formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës së kundërvajtjes i përcakton ministri i Transportit dhe Lidhjeve.

Neni 39

Komisionin për Vendimmarrje për Kundërvajtje në Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve nga ky nen e formon ministri i Transportit dhe Lidhjeve dhe përbëhet prej dy anëtarëve dhe kryetarit.

Anëtarët e Komisionit duhet të kenë të mbaruar arsim të lartë dhe përvojë pune së paku dy vjet, kurse kryetari është jurist i diplomuar me provim të dhënë të jurisprudencës dhe përvojë pune së paku katër vjet.

Neni 39-a

Dorëzimi i njoftimeve dhe vendimeve të Komisionit për Vendimmarrje për Kundërvajtje, bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative.

Nëse vendbanimi i personit të cilit njoftimi ose vendimi duhet t'i dorëzohet, është i panjohur për organin të cilit i dorëzohet me shkrim, Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje do ta publikojë njoftimin, përkatësisht vendimin në tabelën e shpalljes në Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve dhe me kalimin e tetë ditëve nga dita e publikimit në tabelën e shpalljes në Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve, do të konsiderohet se dorëzimi është i rregullt

Neni 40

Kur inspektori komunal i komunës, inspektori komunal i komunave në qytetin e Shkupit, inspektori komunal i qytetit të Shkupit, përkatësisht nëpunësi i uniformuar policor dhe kujdestari komunal do të përcaktojnë se është kryer kundërvajtje nga neni 33 i këtij ligji, harton procesverbal në të cilën shënohen elementet esenciale të kundërvajtjes, vendi, koha dhe mënyra e kryerjes së kundërvajtjes, përshkrimi i veprimit të kundërvajtjes dhe personat e ndeshur aty për aty, si dhe mënyra në të cilën do të mënjanohen pasojat e dëmshme nga kundërvajtja.

Inspektori komunal i komunës, inspektori komunal i komunave në qytetin e Shkupit, përkatësisht inspektori komunal i qytetit të Shkupit, nëpunësi i uniformuar policor dhe kujdestari komunal kryerësit do t'i dorëzojë mandatpagesë në të cilën theksohen elementet esenciale të veprimit, prej ku del shënimi juridik i kundërvajtjes emri personal, adresa dhe numri unik amë i qytetarit, nëse bëhet fjalë për të huaj edhe numri i dokumentit dhe shteti, kurse për personin juridik, emri, selia dhe numri tatimor, vendi dhe koha e kryerjes së kundërvajtjes, kualifikimi juridik i kundërvajtjes, shuma e gjobës, numri i llogarisë për pagesë dhe udhëzimi juridik, me afat prej tetë ditësh nga dorëzimi i mandatpagesës ta paguajë gjobën në shumën e caktuar apo në afatin prej 30 ditësh në vend të gjobës kryerësi të kryejë punë të caktuara - punë me dobi të përgjithshme.

Nëse kryerësi i kundërvajtjes të cilit i është dorëzuar mandatpagesa pranon të kryejë punë me dobi të përgjithshme, detyrohet në afat prej tri ditësh pas realizimit të dorëzimit të dorëzimit vërtetim për punën e kryer me dobi të përgjithshme te inspektori, përkatësisht nëpunësi i uniformuar policor apo kujdestari komunal që e ka udhëzuar në punën me dobi të përgjithshme. Vërtetimin e lëshon drejtori i ndërmarrjes publike për mirëmbajtjen e pastërtisë publike apo drejtori i personit juridik ku kryhet puna me dobi të përgjithshme, në bazë të raportit me shkrim të hartuar nga personi i autorizuar nga drejtori i ndërmarrjes publike për mirëmbajtjen e pastërtisë publike apo drejtori i personit juridik për kontroll gjatë realizimit të punës me dobi të përgjithshme.

Nëse kryerësi i kundërvajtjes është i mitur në këtë rast veprohet në pajtim me Ligjin për kundërvajtje dhe Ligji për të drejtat e fëmijëve.

Ministri i Transportit dhe Lidhjeve i përcakton llojin, lartësinë dhe vlerën e punës me dobi të përgjithshme për çdo kundërvajtje veçmas, si dhe mënyrën e realizimit të saj në pajtim me ministrin e Drejtësisë. Lartësia e mjeteve të dedikuara për punën me dobi të përgjithshme nuk mund të jetë më e lartë se lartësia e gjobës së përcaktuar për kundërvajtje me ç'rast vlera e 1 ore pune me dobi të përgjithshme është së paku 50, e më së shumti 125 denarë në varësi nga lloji dhe ndërlikimi i punës me dobi të përgjithshme.

Ndërmarrja publike për mirëmbajtjen e pastërtisë publike apo personi juridik për mirëmbajtjen e pastërtisë publike detyrohet të mbajë regjistër për kryerje të punës me dobi të përgjithshme.

Nëse kryerësi vullnetarisht nuk e paguan gjobën nga paragrafi 2 i këtij neni apo në afat prej 30 ditësh nuk dorëzon vërtetim të lëshuar nga personi zyrtar se ka kryer punë me dobi të përgjithshme, mandatpagesa ka fuqi të dokumentit të plotfuqishëm dhe personi zyrtar do ta dorëzojë te organi kompetent për realizim të plotfuqishëm për realizimin e tij. Kryerësi i cili me largim për shkak të qëndrimit jashtë vendit mund t'i shmanget pagesës së gjobës, detyrohet menjëherë ta paguajë gjobën e shqiptuar me mandatpagesë.

Inspektori komunal i komunës, inspektori komunal i komunave në qytetin e Shkupit, inspektori komunal i qytetit të Shkupit dhe nëpunësi i uniformuar zyrtar detyrohen të mbajnë evidencë për mandatpagesat e lëshuara dhe për rezultatin e procedurave të ngritura.

Në evidencën nga paragrafi 8 i këtij neni mblidhen, përpunohen dhe ruhen të dhënat në vijim: emri dhe mbiemri, përkatësisht emri i kryerësit të kundërvajtjes, vendbanimi, përkatësisht vendqëndrimi, selia, lloji i kundërvajtjes, numri i mandatpagesës që i lëshohet dhe rezultati i procedurës.

Të dhënat personale nga paragrafi 9 i këtij neni ruhen pesë vjet nga dita e futjes në evidencë.

Formën dhe përmbajtjen e vërtetimit për punën e kryer me dobi të përgjithshme, si dhe formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit për kryerje të punës me dobi të përgjithshme i përcakton ministri i Transportit dhe Lidhjeve.

Formën dhe përmbajtjen e mandatpagesës i përcakton ministri i Transportit dhe Lidhjeve.

Neni 40-a

I fshirë 15

Neni 40-b

Matja e lartësisë së gjobës për personin juridik përkatësisht për tregtarin individ bëhet në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.

Neni 41

I fshirë 16

Neni 42

I fshirë

Neni 42-a

Mjetet prej gjobave të shqiptuara në procedurën e mandatore nga ana e rojtarëve komunale, inspektorët komunalë të komunës së komunave, inspektorët komunalë të komunave në Qytetin e Shkupit dhe të qytetit të Shkupit, si dhe mjetet nga gjobat e shqiptuara në procedurën për kundërvajtje të ngritur me kërkesë të inspektorëve komunalë të komunave në komunat, inspektorët komunalë të komunave në Qytetin e Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit, janë të ardhura të komunave, komunave në Qytetin e Shkupit dhe të Qytetit të Shkupit.

Mjetet nga gjobat e shqiptuara në procedurën e mandatare dhe mjetet nga gjobat e shqiptuara në procedurën për kundërvajtje të ngritur me kërkesë të nëpunësve policorë me uniformë janë të ardhura të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë.

VII. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 43

Dispozitat më të përafërta të parapara me këtë ligj do të miratohen në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 44

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji pushon të vlejë Ligji për mirëmbajtjen e higjienës publike, grumbullimin dhe transportimin e hedhurinave të forta dhe teknologjike komunale "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 37/1998).

Neni 45

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".